



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Investimet Publike në Sektorin e Arsimit

Trendët Historike në Sektorin e Arsimit të Lartë 2008-2010

“... arsimi nuk është pjesë e jetës, por vetë jeta...”

Publikimi i këtij Raporti është Përkrahur nga Royal Norwegian Embassy. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e RNE-së.



INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Hyrje	5
Fondet Publike në Sektorin e Arsimit 2004-2007	6
Fondet Publike në Sektorin e Arsimit 2008-2010	7
Kategoritë e Shpenzimeve 2008-2010	8
Fondet sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013	9
Modalitetet e Investimeve Publike në Arsimin e Lartë	10
Korniza ligjore e Financimit të IAL	11
Struktura e Organizimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë	12
Programet e Studimit	13
Fondet Publike në Arsimin e Lartë 2008-2010	14
Investimet në vitin 2008	14
Investimet në vitin 2009	15
Investimet në vitin 2010	16
Investimet në Projekte Kapitale	17
Falënderime	18
Rreth Lëvizjes FOL	18

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AAK - Agjencia e Akreditimit e Kosovës

AAP - Arsimit dhe Aftësimi Profesional

AAL - Arsimit i Lartë

BE - Bashkimi Evropian

BPrAL - Bartësit Privat të Arsimit të Lartë

DAL - Departamenti i Arsimit të Lartë

EKPB - Ekipi i Kosovës për Promovimin e Bolonjës

ENQA - Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

GAP - Instituti i Studimeve të Avancuara

GDP - Gross Domestic Product (Bruto Produkti Vendor)

IAL - Institucionet e Arsimit të Lartë

IPA - Instrumenti për Ndihmë për Përafrim

IPAL - Institucionet Publike të Arsimit të Lartë

KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

KIPRED - Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

KKSH - Këshilli Kombëtar i Shkencës

MASHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

MEF - Ministria e Ekonomisë dhe e Financave

MFP - Menaxhimi i Financave Publike

PB - Procesi i Bolonjës

PSAK - Plan Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë 2011 -2016

SMZH - Synimet e Mileniumit për Zhvillim

UNMIK - United Nations Mission Interim in Kosovo (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara)

UP - Universiteti i Prishtinës

Përmbledhje Ekzekutive

Në periudhën 2004-2007 janë investuar gjithsej 121.407.103.00 €. Në vitin 2004 janë investuar në total 35.997.361.00 €, në 2005 24.549.178.00 €, në 2006 27.060.408.00 € dhe në 2007 33.850.136.00€. Ky trend i investimeve tregon për një gjendje të pandryshueshme sa i përket fokusit në ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor në përgjithësi;

Prej vitit 2008-2010 janë investuar gjithsej 146.194.414.00 €. Në vitin 2008 janë investuar gjithsej 56.219.869.00 €, në vitin 2009 52.264.372.00 €, ndërkaq në vitin 2010 ka pasur rënie në këto investime me gjithsej 37.709.899.00 €;

Fondet Publike sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013 do të jenë 174.323.565.00 €. Për vitin 2011 parashihen gjithsej 57.717.025.00 €, në 2012 55.118.417.00 € dhe në vitin 2013 do të rriten në 61.418.063.00 €;

Struktura e organizimit të institucioneve të arsimit të lartë kompozohet prej 2 universiteteve publike, 10 kolegjeve universitare private, 5 shkollave profesionale dhe 3 instituteve. Në kuadrin e tyre funksionojnë 122 janë programe publike, 69 private, 6 nga institutet dhe 14 nga shkollat profesionale. Këto programe përfshijnë nivelin e studimeve themelore (Bachelor) dhe ato post-diplomike (Master).

Gjatë vitit 2008 në arsimin e lartë janë investuar gjithsej 15,348,66.73 €. Prej tyre 8,411,337.00 € janë shpenzuar për paga dhe mëditje, 3,291,897.00 € për mallra dhe shërbime, 1,185,280.00 € për shpenzime komunale dhe 2,346,352.73 € për investime kapitale. Prej tyre Universiteti i Prishtinës ka shpenzuar 7,373,262.00 për paga dhe mëditje, 2,878,146.00 për mallra dhe shërbime, 945,280.00 për shpenzime komunale. Qendra e studentëve ka shpenzuar në të gjitha kategoritë gjithsej 1,184,851.00 €, Institutet 480,713.00 € dhe Instituti Pedagogjik 116,046.00 €;

Gjatë vitit 2009 në arsimin e lartë janë investuar në total 13,668,461.07. Prej tyre Qeveria e Kosovës ka investuar 8,579,016.00 € për paga dhe mëditje, 3,370,175.00 € për mallra dhe shërbime, 1,343,997.00 € për shpenzime komunale dhe 375,273.07 € për investime kapitale. Nga këto investime Universiteti i Prishtinës ka marrë 7,569,758.00 € për paga dhe mëditje, 3,061,424.00 € për mallra dhe shërbime dhe 947,256.00 € për shpenzime komunale. Qendra e Studentëve ka shpenzuar 661,994.00 € për paga dhe mëditje, 182,000.00 për mallra dhe shërbime dhe 337,000.00 € për shpenzime kapitale. Institutet kanë shpenzuar 283,267.00 € për paga dhe mëditje, 103,751.00 € për mallra dhe shërbime dhe 54,741.00 € për shpenzime komunale;

Në vitin 2010 janë destinuar gjithsej 15,914,402.00 € për arsimin e lartë. Prej tyre Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2009 ka investuar 11,132,348.00 € për paga dhe mëditje, 3,301,205.00 € për mallra dhe shërbime, 1,480,849.00€ për shpenzime komunale dhe € 2,248,305.29 € për investime kapitale. Nga këto investime Universiteti i Prishtinës ka marrë 10,090,933.00 € për paga dhe mëditje, 2,947,297.00 € për mallra dhe shërbime dhe

1,094,562.00 € për shpenzime kapitale. Qendra e Studentëve ka shpenzuar 646,565.00 € për paga dhe mëditje, 201,286.00 € për mallra dhe shërbime dhe 337,000.00 € për shpenzime komunale. Institutet kanë shpenzuar 321,499.00 € për paga dhe mëditje, 118,927.00 € për mallra dhe shërbime dhe 40,287.00 € për shpenzime komunale. Instituti Pedagogjik ka shpenzuar 73,351.00 € për paga dhe mëditje, 33,695.00 € për mallra dhe shërbime dhe 9,000.00 € për shpenzime komunale;

Qeveria e Kosovës ka investuar gjithsej 4,969,931.09 € në projektet kapitale. Në kuadër të këtyre projekteve hyjnë Instituti I Historisë, Ndërtimi i Konviktit të Studentëve në Prishtinë, Renovimi I Fakultetit të Mjekësisë, Ndërtimi i Fakultetit të Edukimit në Prishtinë, Renovimi I Institutit Albanologjik, Ngritja e Infrastrukturës, etj.

Hyrje

Procesi i shtet-ndërtimit në Republikën e Kosovës vazhdon të shoqërohet me probleme dhe sfida strategjike: papunësia, varfëria, korrupsioni, moshëzrillimi ekonomik, mungesa e demokracisë dhe gjendja e mjerueshme në sistemin shëndetësor. Megjithatë, arsimimi përbën sfidën dhe njëherazi mundësinë kryesore për shoqërinë dhe institucionet e Kosovës. Mungesa e cilësisë dhe autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, infrastruktura e dobët, stafi i pamjaftueshëm akademik, mungesa e bërjes së hulumtimeve dhe fondet e varfra publike janë vetëm disa nga problemet që janë duke ndikuar në nivelin e dobët të këtij sektori. Duke qenë se orientimet tona janë të drejtuara drejt një “shoqërie të dijes” dhe “shoqërie të konkurrencës”, ngase vetëm në këtë mënyrë mund të integrohemi në “tregun e punës” dhe “tregun e ideve”, përpjekjet dhe angazhimet e institucioneve të Kosovës kanë qenë të pamjaftueshme për arritjen dhe përmbushjen e këtyre synimeve. Nëse marrim parasysh skemën buxhetore të Qeverisë së Kosovës për këtë sektor, shihet qartazi se arsimi në Kosovës ende nuk konsiderohet prioritet i institucioneve tona. Në vend që Qeveria e Kosovës t’i intensifikojë përpjekjet e saj për ta ngritur nivelin e fondeve publike për sektorin e arsimit, ajo në vitin 2010 ka reduktuar buxhetin e saj. Mirëpo nëse marrim mesataren në përgjithësi, thuajse të gjitha vendet në rajon janë prapa standardeve ndërkombëtare. Sipas këtyre standardeve, fondet publike duhet të jenë mbi 6% e GDP-së për arsimin në përgjithësi¹, ku 2% prej tyre duhet të

destinohen për atë të lartë. Gjersa vendet në rajon shpenzojnë 4% të GDP-së në arsim (me përjashtim të Sllovenisë, e cila shpenzon 6% të GDP-së), Islanda shpenzon 8%, Korea e Jugut mbi 7%, Finlanda mbi 6%. Në termet e shpenzimeve qeveritare për arsimin e lartë, në top listë janë Danimarka, Finlanda, Norvegjia dhe Zvicra - të gjitha këto vende shpenzojnë rreth 2% të GDP-së. Ndërkaq, nëse përfshijmë edhe shpenzimet private, SHBA-të janë në krye-listë me 3% të GDP-së (2/3 nga fonde private), Korea e Jugut rreth 2.3% (3.5 herë më shumë private sesa publike), Kili mbi 2% (85% shpenzime private), Izraeli rreth 2%, Finlanda rreth 1.7 të GDP-së. Ndërkaq, vendet në rajon janë nën 1% të GDP-së për Arsimin e Lartë, me përjashtim të Sllovenisë e cila e ka 1.26% dhe Mali i Zi me 1.10%. Pakëz më keq qëndron Kroacia me 0.76% dhe Serbia me 0.90%.² Këto shpenzime qeveritare përfshijnë: mirëmbajtjen, përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, shpenzimet e ndërlidhura për mësimdhënie dhe hulumtime - rrogat e stafit, materialet dhe pajisjet (duke përfshirë laboratorët dhe bibliotekat), hartimin dhe përmirësimin e programeve, shpenzimet e ndërlidhura për administratën, për studentët dhe hulumtuesit, bashkëpunimin ndër-institucional dhe ndërkombëtar. Duke marrë parasysh që përvoja e Kosovës me arsimin e lartë është shënjuar dhe daton vetëm katër dekada më parë, kjo duhet të jetë një përgjegjësi shtesë që

ernizimin e Agjendës për Universitet: Edukimi, Hulumtimi dhe Inovacioni, COM (2006) 208, Bruksel, 10 qershor, 2006

² Me gjerësisht shih Financimi i Arsimit të Lartë në Evropën Juglindore: Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia, Qendra për Politika Edukative, Beograd, 2009

¹ Për më shumë detaje shih Komunikatën e Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Evropian, Përpjekja mbi mod-


INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

institucionet e Kosovës t'i kushtojnë më shumë vëmendje dhe rëndësi reformimit të këtij segmenti, në mënyrë që të zënë hapin me zhvillimet aktuale globale. Disa ndryshime dhe lëvizje pozitive janë bërë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, mësimdhënies dhe elementëve tjera. Pastaj “tregu i edukimit” është hapur edhe për futjen e kolegjeve universitare private, të cilat ndonëse kanë qenë të shumta në numër, së fundmi procesi i akreditimit ka filtruar kolegjet më të mira të cilat sigurojnë cilësi të mjaftueshme në fushën e mësimdhënies dhe bërjes së hulumtimeve të ndryshme. Është hapur edhe Universiteti i Dytë Publik në Prizren³, i cili ka pranuar 1200 studentë dhe mendohet të funksionojë sipas standardeve ndërkombëtare. Mirëpo, konsiderojmë që Qeveria e Kosovës duhet të destinojë më shumë fonde publike për Institucionet e Arsimit të Lartë, qoftë publike, qoftë private, në mënyrë që të ngritët cilësia në këtë sektor.

Fondet Publike në Sektorin e Arsimit 2004-2007

Sektori i arsimit përbën mundësinë kryesore të çdo shoqërie për t'u zhvilluar ekonomisht dhe për t'u emancipuar në rrjedhat kulturore dhe politike. Ky sektor konsiderohet ndër segmentet më të

rëndësishme të çdo shteti i cili synon të jetë konkurrent krahas shteteve të zhvilluara. Kosova ende nuk e ka të qartë rrugën e saj sa i përket fondeve publike për arsimimin e të rinjve, të cilët do të mund të integroheshin në proceset e ndërvlerësimit dhe globalizimit. Nëse i analizojmë trendët historike 2004-2007, shohim se gjatë këtij intervali kohor janë investuar gjithsej 121.407.103.00 Euro në sektorin e arsimit në përgjithësi. Në vitin 2004 janë investuar gjithsej 35.997.361.00 €, në 2005 24.549.178.00 €, në 2006 27.060.408.00 € dhe në 2007 gjithsej 33.850.136.00€.⁴ Ky trend i investimeve tregon për një gjendje të pandryshueshme sa i përket fokusit në ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor në përgjithësi.



Tab: (1) Trendët historike 2004-2007 në Arsim

³ Vendimi i Qeverisë së Kosovës, Nr. 10/148, 5 qershor, 2010.

⁴ Rreth statistikave të investimeve në sektorin e arsimit shih <http://www.mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>


INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

Trendët e fondeve publike në arsim 2008-2010

Nëse i marrim në analizë krahasuese vitet para 2008, atëherë shohim se ka pasur një progresion sa i përket investimeve në sektorin e arsimit. Derisa gjatë viteve 2004-2007 (4 vite) ishin investuar 121.457.103.00 €, gjatë tri viteve të fundit (2008-2010) janë investuar 146.194.414 €. Kjo tregon për një rritje solide të buxhetit për sistemin arsimor.

Derisa në vitin 2008 janë investuar gjithsej 56.219.869.00 € dhe në vitin 2009 52.264.372.00 €, në vitin 2010 ka pasur rënie në këto investime me gjithsej 37.709.899.00 €. Megjithatë, kjo rritje në tre vitet e fundit duhet të analizohet edhe në kontekst të rritjes së buxhetit të Kosovës, gjë që në vitet e mëparshme nuk ka qenë i tillë. Pra, nëse vlerësojmë përqindjen e investimeve në arsim krahas GDP-së së përgjithshme, atëherë nuk mund të themi se kemi përparim dhe rritjeve të fondeve publike për sektorin e arsimit.

**Investimet Publike në Sektorin e Arsimit
2008-2010**



Tab: (2) Trendët e fondeve publike 2008-2010.

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

Kategoritë e Shpenzimeve 2008-2010

Ky buxhet prej 146.194.414.00 € është

shpenzuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe

shërbimeve,

shpenzimeve komunale, subvencione dhe

investime kapitale. Për

tre vitet e fundit, në

kuadër të kategorisë së

pagave dhe mëditjeve

janë shpenzuar gjithsej

16.294.865.00 €, në

kategorinë e mallrave

dhe shërbimeve

16.384.506.00 € dhe në

atë të shpenzimeve

komunale gjithsej 3.219.002.00 €.

Ndërkaq, sa i përket kategorisë së

subvencioneve janë shpenzuar 27.000.00

€ në vitin 2008, në vitin 2009 27.000.00 €

dhe në vitin 2010

gjithsej

2.195.730.00 €.

Kategoria më e

shpenzuar ka qenë

ajo e shpenzimeve

kapitale, ku në

vitin 2008 janë

shpenzuar

39.124.820.00 €,


në vitin 2009

37.782.999.00 €


dhe në vitin 2010

ka rënë në

23.488.781.00 €.



Tab: (3) Kategoritë e shpenzimeve 2008-2010




Tab: (4) Subvencionet dhe Shpenzimet Kapitale 2008-2010

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

Fondet e parashikuara sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve 2011-2013

Investimet në sektorin e arsimit sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve parashihen të jenë 57,717,025.00 për vitin 2011, 55,188,477.00 për vitin 2012 dhe 61,418,063.00 për vitin 2013. KASHI nuk është një dokument që nuk i nënshtrohet ndryshimeve nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por është një orientim i përgjithshëm i shpenzimeve. Bazuar në këtë projeksione Qeveria duhet t'i merr parasysh kërkesat e tregut dhe në këtë mënyrë të rrisë skemën buxhetore për sektorin e arsimit në përgjithësi dhe atë të lartë në veçanti.



Tab: (5) Investimet e parapara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013

Modalitetet e Investimeve Publike në Arsimin e Lartë

Çështja e financimit të arsimit të lartë përbën njërën ndër çështjet më të diskutuara nga politikanë dhe shkollarë të ndryshëm. Qeveritë rëndom frikësohen që nëse nuk financojnë sektorin e arsimit të lartë do ta humbasin rolin dhe ndikimin e tyre në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL). Megjithatë, universitetet çdoherë e më shumë shikojnë mënyra, mundësi dhe alternativa tjera të financimit. Ndër mënyrat më të shpeshta të përdorura janë: të ardhurat nga pagesa e shkollimit dhe akomodimit, pagesat administrative, pastaj burimet tjera alternative apo të jashtme: projektet hulumtuese dhe kurse trajnimi për industri apo kompani të ndryshme. Andaj, fondet publike dhe autonomia e Institucioneve të Arsimit të Lartë përbëjnë ndër çështjet më të nxehta të diskutimeve në qarqet politike dhe shkencore. Duke qenë që pranohet gjerësisht se asnjë arsim i lartë nuk mund të jetë tërësisht autonom nga ndikimet e jashtme (Meek, 2003: 7), Qeveria duhet të ndërhyjë sa më pak në përcaktimin dhe funksionimin e politikave dhe të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL). Problemi tjetër ka të bëjë me sferën e hulumtimeve. Duke u bazuar në trendët aktuale shihet se fokusi kryesor i universiteteve nuk është mësimdhënia më, por hulumtimet. P.sh. Kroacia dhe Serbia për hulumtime shpenzojnë 0.32% të GDP-së, ndërsaq Mal i Zi 0.30%. Kështu që, universitetet publike dhe ato private në Kosovë duhet të orientohen drejt këtij segmenti/komponenti vital, në rë që të rinjtë të integrohen dhe të bëhen konkurrentë në procesin e ndërvlerësimit

apo globalizimit. Problemi i tretë ka të bëjë me infrastrukturën universitare. Siç dihet, hapësira e studimit në UP nuk është e mjaftueshme, madje edhe rritja e numrit të pranimit të studentëve mbi 18.000 do ta evidentojë edhe më shumë këtë problem. Problemi i katërt konsiston në stafin a pamjaftueshëm akademik dhe shpeshherë deficitar, duke qenë që një pjesë e konsiderueshme prej tyre janë vetëm me tituj Master. Edhe raporti numerik profesor student është jashtëzakonisht i lartë. Ndërkaq, sipas standardeve, do të duhej të ishte 16 studentë për një profesor. Sllovenia dhe Kroacia e kanë 23:1, ndërsaq Serbia dhe Mal i Zi 29:1. Prandaj, në këtë raport do të shtjellohen këto dilema dhe probleme kronike që janë duke e shoqëruar Arsimin e Lartë në Kosovë. Mirëpo, duke qenë që mungojnë statistika dhe hulumtime të natyrës së tillë, nuk mund të nxjerrim ende ndonjë statistikë sesa është ky raport numerik. Problemi i pestë ka të bëjë me përkrahjen institucionale për studentët e zellshëm dhe të shkëlqyeshëm në studime. E tëra që bëhet për këta studentë është ndarja e bursave në vlera aspak inkurajuese. Sllovenia ndanë 158 euro në muaj për studentë që tregojnë nivel të lartë të angazhimit në studime. Pastaj janë edhe format tjera të mbulimit të shpenzimeve të shkollimit përveç bursave: grantet, huadhënie dhe angazhimi nëpër institucione të ndryshme për punë sezonale. Megjithatë, nuk ka asnjë model standard që aplikohet nga vendet e ndryshme. P.sh. Danimarka aplikon sistemin “Taximeter”, pastaj Britania e Madhe financon studentët që vijnë nga grupet e nën-përfaqësuar dhe me aftësi të kufizuar, Norvegjia me sistemin e saj

State Loan Fund mbështetë studentët për t'i kryer studimet e tyre dhe më pastaj t'i kthejnë paratë e tyre, etj. etj. Andaj, duke parë më shqetësim mungesën e informacioneve dhe publikimeve për sferën e Arsimit të Lartë, Lëvizja "FOL", me përkrahjen e Ambasadës Mbretërore Norvegjeze, është duke realizuar një hulumtim sesi ka rrjedhur trendi i fondeve publike për këtë sektor dhe i cili pritët të ngërthejë në vete edhe një analizë krahasuese me vendet tjera në rajon. Andaj, krahasimi i sistemit tonë të edukimit me disa nga vendet tjera do të bëjë që të kuptohet më mirë pozicioni i institucioneve tona në relacion me Arsimin e Lartë dhe praktikat e tyre të jenë një udhërrëfyes për sistemin tonë të edukimit në përgjithësi dhe atij të lartë në veçanti.

Korniza ligjore mbi financimin e IAL

Financimi i bartësve publikë dhe privat rregullohet sipas ligjit aktual mbi arsimin e lartë. Sipas këtij ligji, parimet kryesore të financimit janë:

- Fonde nga Ministria për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm;
- Tarifat e shkollimit dhe pagesa të tjera që bëjnë studentët;
- Pagesa për shërbime komerciale dhe shërbime të tjera;
- Donacione, dhurata dhe ndihma;
- Kontrata me organizma kombëtare, ndërkombëtare, publike ose private në fushën e

mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të konsulencës⁵.

Edhe në nenin 23 të këtij ligji specifikohet se edhe Bartësit Privat të Arsimit të Lartë mund të përfitojnë nga skema buxhetore e qeverisë së Kosovës në interes të përgjithshëm.⁶ Përveç financimit të IAL-ve, ministria e ka për obligim të krijojë edhe mundësi për të mbështetur studentët që vijnë studimet e tyre në këto institucione. Megjithatë, financimi i bartësve dhe studentëve nuk mund të shërbejë edhe si instrument i diktimit të politikave universitare nga ana e strukturave qeveritare. Një gjë të tillë e ndalon edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke garantuar autonominë e universiteteve dhe Institucioneve tjera të arsimit të lartë.⁷ Kjo kornizë aktuale ligjore mbi arsimin e lartë nuk është në përputhje me rrethanat dhe realitetin e krijuar. Duke parë dobësitë e shumta që ekzistojnë në ligjin mbi arsimin e lartë, MASHT-i, së bashku me ekspertë dhe institucione tjera relevante, kanë hartuar një projekt-ligj të ri i cili do të miratohet në Kuvendin e Kosovës.⁸

⁵ Neni 16 i Rregullores nr. 2003/14 për shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, 12 maj, 2003

⁶ Po aty, neni 23 – Dispozita për dhënie mjeteve financiare nga fondet publike


⁷ Më gjerësisht shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 58, miratuar me 15 qershor 2008

⁸ Për më shumë detaje rreth ndryshimeve shih <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=1229>

Struktura e Organizimit të Arsimit të Lartë

Struktura e organizimit të Arsimit të Lartë në Kosovës përbëhet nga Universitetet Publike, Kolegjet Universitare Private, Institutet dhe Shkollat Profesionale. Sipas vendimit të fundit të Qeverisë së Kosovës skema e Institucioneve të Arsimit të Lartë përbëhet nga 2 Universitete Publike, 10 kolegje universitare private, 5 shkolla profesionale dhe 3 institute.⁹

Numri i Institucioneve të Arsimit të Lartë



Tab: (6) Institucionet e Arsimit të Lartë

Kjo qartësi e Institucioneve të Arsimit të Lartë ka ardhur si rezultat i punës së Agjencisë së Akreditimit Kosovar, e cila bën vlerësimin e cilësisë së bartësve të tillë të arsimit privat. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi janë elemente të rëndësishme në arsimin e lartë në kohën

e sotme dhe diktohen nga një kontekst i gjerë shoqëror, politik dhe ekonomik duke pasur si qëllim final arritjen e një niveli të krahasueshëm me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Prandaj, sigurimi i cilësisë trajtohet edhe si njëra nga shtyllat kryesore të Procesit të Bolonjës. Edhe pse e paraparë që Agjencia Kosovare për Akreditim (AKA), të themelohet dhe funksionalizohet në vitin 2004 kjo nuk ka ngjarë deri në vitin 2008.¹⁰ Deri në vitin 2008 nuk ka patur as proces të akreditimit dhe licencat janë lëshuar përmes kriterëve dhe procedurave

jotransparente dhe nuk kanë qenë në përputhshmëri të duhur me LAL dhe aktet nënligjore ekzistuese. Po ashtu, ka pasur edhe pranime të studentëve në programe të studimit, të palicencuara. Procesit të akreditimit në vitin 2008 i ka paraprirë vendimi i MASHT, me të cilin janë obliguar

të gjitha Institucionet e arsimit të lartë (IAL) publik dhe privat që të themelojnë zyrat për sigurim të cilësisë. Keto zyra kanë pasur rol kryesor në procesin e vetëvlerësimit dhe në përgatitjen e institucioneve për procesin e akreditimit i cili ka filluar kur Qeveria e Republikës së Kosovës dhe MASHT kanë angazhuar një agjenci të jashtme - Këshilli Britanik

⁹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës, Nr. 04/134, 14 Korrik, 2010.


¹⁰ Më shumë rreth AAK-së shih <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=1265>

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

për Akreditim (KBA). KBA ka bartur këtë proces deri në funksionalizimin e plotë të AKA-së duke aplikuar kriteret për akreditim të përpiluar nga Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës. (AKA) ka marrë pjesë si vëzhgues në procesin e inspektimit të kryer nga Këshilli Britanik i Akreditimit dhe në ndërkohë është konsoliduar plotësisht. AKA është funksionalizuar plotësisht në vitin 2008 dhe që nga tetori 2008, ka filluar procesin e dytë të akreditimit për BprAL duke aplikuar standardet e ENQA . Gjatë tërë këtij procesi, MASHT ka përkrahur sektorin privat duke siguruar një ambient të rregulluar si dhe duke u angazhuar që ky sektor të përfitojë nga programet e Komisionit Evropian (TEMPUS) në konsolidimin e mëtutjeshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë. Një kohe shumë të gjatë, arsimi i lartë në Kosovë ka nënkuptuar pothuajse vetëm Universitetin e Prishtinës, ndërsa tani ky sektor është shumë më i pasur në numër dhe shumë divers në profilin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Në vitin 2009 janë akredituar 7 kolegje, 3 institute dhe 3 shkolla të larta profesionale, ndërsa në vitin 2010 janë riakredituar dhe akredituar gjithsejtë 10 kolegje, 3 institute dhe 5 shkolla të larta profesionale. Në vitin 2010 është finalizuar procesi i akreditimit të Universitetit të Prishtinës në nivel institucional dhe programor si dhe është

akredituar Universiteti i Prizrenit me 6 programe studimi. Krahësuar me vendet e regjionit të cilat kanë ngecje në këtë fushë, Republika e Kosovës ka një sektor të akredituar të arsimit të lartë dhe një agjension akreditimi i cili funksionon sipas kriterëve dhe standardeve të ENQA. AKA është në fazën përgatitore për aplikim për anëtarësim në këtë rrjet (ENQA).

Ndërkaq, sa i përket programeve, shohim se 122 janë programe publike, 69 private, 6 nga institutet dhe 14 nga shkollat profesionale. Këto programe përfshijnë nivelin e studimeve themelore (Bachelor) dhe ato post-diplomike (Master). Megjithatë, një përshkrim më i detajuar i këtyre programeve dhe kategorizimi i tyre do të bëhet para publikimit të këtij Raporti.




Tab: (7) Numri dhe klasifikimi i programeve të studimit - sipas akreditimit të vitit 2010

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTË

Fondet Publike në arsimin e lartë - 2008-2010

Investimet në arsimin e lartë janë nën nivelin e kërkuar të standardeve dhe praktikave ndërkombëtare. Sipas këtyre standardeve përqindja e GDP-së duhet të jetë mbi 6% për sektorin e Arsimit në përgjithësi, ndërsa për arsimin e lartë duhet të jenë mbi 2%. Megjithatë, Kosova është ende larg këtyre standardeve, pasi që shumë pak është duke investuar në këtë sektor. Mungesa vërehet veçmas në sektorin e hulumtimeve shkencore ku universitetet dhe kolegjet universitare janë ende në kuadër të sferës së mësimdhënies dhe shumë pak në rrafshin shkencor.

Investimet në vitin 2008 - Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2008 ka investuar 8,411,337.00 € për paga dhe mëditje, 3,291,897.00 € për mallra dhe shërbime, 1,185,280.00 € për shpenzime komunale dhe 2,346,352.73 € për investime kapitale. Tabela e mëposhtme tregon se Universiteti I Prishtinës ka shpenzuar 7,373,262.00 për paga dhe mëditje, 2,878,146.00 për mallra dhe shërbime, 945,280.00 për shpenzime komunale. Qendra e studentëve ka shpenzuar në të gjitha kategoritë gjithsej 1,184,851.00 €, Institutet 480,713.00 € dhe Instituti Pedagogjik 116,046.00 €.




Tab: (8) Fondet publike në Arsimin e Lartë 2008

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTE

Investimet në vitin 2009 - Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2009 ka investuar 8,579,016.00 € për paga dhe mëditje, 3,370,175.00 € për mallra dhe shërbime, 1,343,997.00 € për shpenzime kapitale dhe 375,273.07 € për investime kapitale. Nga këto investime Universiteti I Prishtinës ka marrë 7,569,758.00 € për paga dhe mëditje, 3,061,424.00 € për mallra dhe shërbime dhe 947,256.00 € për shpenzime komunale.

Qendra e Studentëve ka shpenzuar 661,994.00 € për paga dhe mëditje, 182,000.00 € për mallra dhe shërbime dhe 337,000.00 € për shpenzime kapitale. Institutet kanë shpenzuar 283,267.00 € për paga dhe mëditje, 103,751.00 € për mallra dhe shërbime dhe 54,741.00 € për shpenzime komunale. Instituti Pedagogjik ka shpenzuar 63,997.00 € për paga dhe mëditje, 23,000.00 € për mallra dhe shërbime dhe 5,000.00 € për shpenzime komunale.




Tab: (9) Fondet publike në Arsimin e Lartë 2009

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTË

Investimet në vitin 2010 - Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2009 ka investuar 11,132,348.00 € për paga dhe mëditje, 3,301,205.00 € për mallra dhe shërbime, 1,480,849.00€ për shpenzime komunale dhe € 2,248,305.29 € për investime kapitale. Nga këto investime Universiteti i Prishtinës ka marrë 10,090,933.00 € për paga dhe mëditje, 2,947,297.00 € për mallra dhe shërbime dhe 1,094,562.00 € për shpenzime kapitale.


Qendra e Studentëve ka shpenzuar 646,565.00 € për paga dhe mëditje, 201,286.00 € për mallra dhe shërbime dhe 337,000.00 € për shpenzime komunale. Institutet kanë shpenzuar 321,499.00 € për paga dhe mëditje, 118,927.00 € për mallra dhe shërbime dhe 40,287.00 € për shpenzime komunale. Instituti Pedagogjik ka shpenzuar 73,351.00 € për paga dhe mëditje, 33,695.00 € për mallra dhe shërbime dhe 9,000.00 € për shpenzime komunale.



Tab: (10) Fondet publike në Arsimin e Lartë 2010

INVESTIMET PUBLIKE NË ARSIMIN E LARTË

Qeveria e Kosovës ka investuar gjithsej 4,969,931.09 € në projektet kapitale. Në kuadër të këtyre projekteve hyjnë Instituti I Historisë, Ndërtimi i Konviktit të Studentëve në Prishtinë, Renovimi I Fakultetit të Mjekësisë, Ndërtimi i Fakultetit të Edukimit në Prishtinë, Renovimi I Institutit Albanologjik, Ngritja e Infrastrukturës, etj.



Tab: (11) Fondet publike në Projektet Kapitale në Arsimin e Lartë 2008-2010

tjera deformuese të qeverisjes.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Mbretërore Norvegjeze. Ky Raport është produkt i një pune të përkushtuar nga stafi i Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mund të shkarkohen në këtë ëebfaqe: ëëë.monikorr.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave

Kontakt:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org